

V E N D I M
Nr. 46, datë 13.6.2002

**PËR NJË SHITESË NË RREGULLOREN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
MIRATUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.357, DATË 9.4.1998, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.399, DATË 4.2.1999 DHE ME VENDIMIN NR.31,
DATË 2.5.2002**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe 172 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

I. Miratohet pjesa shtesë III/a në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me titull “Procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

**PJESA III/A
PROCEDURA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

I. Fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit

Neni 169/1

Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet në përputhje me kërkesat e neneve 86, 87, 88 pika 2 dhe 91 të Kushtetutës.

Neni 169/2

Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se 14 ditë nga afati i përcaktuar në nenin 88 pika 2 të Kushtetutës, inicion fillimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit dhe thërret në mbledhje të veçantë Byronë e Kuvendit.

Neni 169/3

Kryetari i Kuvendit bën regjistrimin e kandidatëve për President, sipas procedurave administrative të funksionimit të Kuvendit.

Ai ngarkon Komisionin e Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore të bëjë verifikimin e kriterëve ligjore për plotësimin e dokumentacionit për kandidatët për President.

Më pas ky dokumentacion i bëhet i njohur Byrosë Parlamentare dhe seancës plenare.

Neni 169/4

Kur ka ankime për interpretimin kushtetues të procedurave për zgjedhjen e Presidentit, parregullsi në dokumentacionin dhe vlefshmërinë e regjistrimit të kandidatit për President, ankimi u paraqitet dy komisioneve: Komisionit të Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe Komisionit të Përhershëm të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores.

Këto komisione, në mbledhje të përbashkët, marrin në shqyrtim ankesën brenda ditës dhe relacionin me vendimin përkatës ia përcjellin seancës plenare.

II. Regjistrimi i kandidatëve për President

Neni 169/5

Kandidati për President i propozohet Kuvendit në përputhje me nenin 87 pika 1 të Kushtetutës.

Dokumentet për regjistrimin e kandidatit për President duhet të jenë në përputhje me nenin 86 pika 2 të Kushtetutës dhe duhet të përmbajnë:

- a) listën e deputetëve propozues me firmat përkatëse;
- b) curriculum vitae të kandidatit për President;
- c) deklaratën e kandidatit që shpreh vullnetin e tij për të kandiduar.

Neni 169/6

Dokumentet për regjistrimin e kandidatit paraqiten te Kryetari i Kuvendit jo më vonë se 24 orë përpara orës së caktuar të votimit të radhës.

Neni 169/7

Në rast se konstatohet se dokumentet nuk janë të plota, u kërkohet propozuesve të bëjnë plotësimet përkatëse. Plotësimi i dokumenteve pas afatit të përcaktuar më sipër nuk përjashton regjistrimin e kandidatit, por në çdo rast ky plotësim duhet të bëhet jo më vonë se 4 orë nga ora e caktuar për votim.

Neni 169/8

Në rast se një kandidat për President jep dorëheqjen para ditës së votimit, grupi i deputetëve propozues ka të drejtë ta zëvendësojë, por jo më vonë se 5 orë përpara fillimit të votimit.

Në votimin e katërt dhe të pestë nuk mund të bëhet zëvendësimi nga grupi i deputetëve propozues në rast se kandidati jep dorëheqjen.

III. Procedura e votimit

Neni 169/9

Kryetari i Kuvendit, në ditën e votimit, hap seancën plenare dhe i paraqet Kuvendit listën e regjistrimit të kandidatëve për President, si dhe propozon fillimin e procedurës së votimit me zgjedhjen e Komisionit të Votimit.

Komisioni i Votimit përbëhet nga jo më shumë se 7 deputetë. Përbërja e tij caktohet sipas raporteve të përfaqësimit politik në Kuvend.

Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe Sekretarin e tij.

Neni 169/10

Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës do të ndiqen këto procedura votimi nga Komisioni i Votimit:

- a) votimi për zgjedhjen e Presidentit bëhet i fshehtë;
- b) votimi bëhet me fletëvotimi;
- c) në fletën e votimit kandidatët për President regjistrohen sipas rendit alfabetik;
- ç) Kryetari i Komisionit merr në dorëzim listën e deputetëve që do të votojnë;
- d) Komisioni përgatit dhomat e fshehta të votimit;
- dh) votimi bëhet duke thirrur sipas listës alfabetike emrat e deputetëve. Në përfundim të listës, Kryetari bën edhe një herë thirrjen e deputetëve që nuk janë paraqitur;

- e) fleta e votimit është e sekretuar;
- ë) fleta e votimit firmoset para shpërndarjes nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari i Komisionit;
- f) fleta e votimit do të ketë emrat e kandidatëve dhe përbri një kuadrat ku do të vendoset shenja, sipas përcaktimit në shkronjën “gj”;
- g) votimi do të bëhet nga të gjithë deputetët vetëm me një lloj stilolapsi;
- gj) shenja e votimit është një “iks” X ose “plus” + në kuadratin e caktuar përbri emrit të kandidatit;
- h) në përfundim të votimit, Kryetari i Komisionit shpall mbylljen e tij dhe urdhëron hapjen e kutisë së votimit;
- i) kutia e votimit hapet në prani të Komisionit dhe të deputetëve në seancë plenare;
- j) Kryetari i Komisionit lexon publikisht çdo fletë votimi;
- k) pas leximit të të gjitha fletëve të votimit, Komisioni nxjerr rezultatin përfundimtar, të cilin e shpall në seancë Kryetari i Komisionit të Votimit duke lexuar numrin e fletëve të votimit të hedhura në kuti, numrin e votave të marra nga çdo kandidat dhe numrin e votave të pavlefshme;
- l) në përfundim plotësohet procesverbali përkatës, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe ai është i vlefshëm kur e nënshkruajnë më shumë se gjysma e anëtarëve;
- ll) fleta e votimit është e pavlefshme dhe nuk llogaritet për asnjë kandidat kur:
 - i) ka më shumë se një shenjë;
 - ii) nuk ka asnjë shenjë;
 - iii) ka shënime të tjera që nuk lënë të kuptohet qartë vullneti i zgjedhësit;
- iv) fleta e votimit është e parregullt (e grisur dhe pa shenjat e sekretimit të caktuar).

Neni 169/11

Çdo deputet ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim lidhur me pretendimet e tij për shkeljen e procedurave të votimit.

Komisioni e shqyrton menjëherë ankesën dhe merr një vendim që i komunikohet seancës. Në rast se konstatohet se ka shkelje thelbësore të procedurës së votimit, Komisioni i Votimit me shumicë votash vendos përsëritjen e procesit të votimit.

IV. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e parë dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/12

Kryetari i Kuvendit, pasi konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare, vendos ditën dhe orën e votimit të parë në Kuvend për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

Neni 169/13

Regjistrimi i kandidatëve për President për votimin e parë bëhet, sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/14

Pas zhvillimit të votimit të parë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit shpallet President i Republikës.

Neni 169/15

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave zhvillohet një votim i dytë, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur në votimin e parë, shprehur në nenet 169/5-169/8 dhe 169/10 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/16

Kryetari i Kuvendit pas deklarimit të rezultateve të votimit të parë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të dytë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

V. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e dytë dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/17

Për votimin e dytë mund të regjistrohen sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores kandidatë të rinj nga një numër jo më pak se 20 deputetë, që nuk kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë, ose kur kandidati që ata propozonin në votimin e parë është tërhequr.

Neni 169/18

Pas zhvillimit të votimit të dytë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit shpallet President i Republikës.

Neni 169/19

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, zhvillohet një votim i tretë.

Neni 169/20

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të dytë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të tretë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e tretë dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/21

Për votimin e tretë mund të regjistrohen sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores kandidatë të rinj nga një numër jo më pak se 20 deputetë që nuk kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë dhe të dytë, ose kur kandidati që ata propozonin në votimin e dytë është tërhequr.

Neni 169/22

Pas zhvillimit të votimit të tretë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Neni 169/23

Në rast se në votimin e tretë ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjë prej tyre nuk ka fituar shumicën e votave, votimi i katërt bëhet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e tretë.

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave zhvillohet një votim i katërt.

Neni 169/24

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të tretë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të katërt, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VII. Votimi i katërt

Neni 169/25

Komisioni për zgjedhjen e Presidentit përgatit fletët e votimit me emrat e dy kandidatëve që plotësojnë kushtin e parashikuar në nenin 169/23 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/26

Në rast se dy kandidatë kanë marrë numër të njëjtë votash në votimin e tretë dhe për nga numri plotësojnë kushtin për të vazhduar në votimin e katërt me një kandidat që ka marrë më shumë vota, kandidati që do të vazhdojë në votimin e katërt vendoset me short. Procedura për hedhjen e shortit zhvillohet nga Komisioni.

Neni 169/27

Pas zhvillimit të votimit të katërt, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Neni 169/28

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, zhvillohet një votim i pestë.

Neni 169/29

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të katërt, vendos për datën dhe orën e zhvillimit të votimit të pestë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare, e cila nuk mund të jetë më vonë se 10 ditë nga votimi i katërt. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VIII. Votimi i pestë

Neni 169/30

Votimi i pestë bëhet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë pjesë në votimin e katërt dhe asnjëri nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave.

Neni 169/31

Pas zhvillimit të votimit të pestë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Kryetari i Kuvendit, në këtë rast, rikonfirmon zyrtarisht në seancë Presidentin e ri dhe cakton ditën e betimit në Kuvend.

IX. Shpërndarja e Kuvendit

Neni 169/32

Në rast se Kuvendi, pas votimit të pestë, nuk arrin të zgjedhë Presidentin e Republikës, Kryetari i Kuvendit shpall shpërndarjen e tij, sipas nenit 87 pika 8 të Kushtetutës.

